

Agim (Rrustem) Shala

(1.03.1963, shqiptar nga Ujmiri/Dobra Voda, komuna e Klinës/Klina, bujk, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Agimi aderoi në UÇK në mars të vitit 1998. Në datën 12.09.1998, pjesëtarët e forcave serbe kishin shtënë ndaj tij dhe të vëllait të bashkëshortes së tij në rrugën para shtëpisë së Agimit [Ujmirë/Dobra Voda, Klinë/Klina]. Agimin e plagosën, ndërsa të vëllain e bashkëshortes e kishin vrarë [të shikohet regjistrimi]. Pjesëtarët e UÇK-së e bartën Agimin në ambulancën e UÇK-së, në fshatin Gradicë/Gradica [Glogoc/Glogovac]. Në datën **24.09.1998**, kur forcat serbe i kishin nisur sulmet ndaj Gradicës/Gradica, mjekët, së bashku me të plagosurit, kaluan në pyll, në bjeshkën e **Çiçavicës/Čičavica**, afër **Dubocit/Dubovac**. Më vonë, pjesëtarët e forcave serbe iu afruan vendit ku qëndronte Agimi dhe e kishin vrarë. Pas tërheqjes së forcave serbe, banorët e kishin varrosur Agimin në afërsi të varrezave në Gradicë/Gradica. Pas luftimeve në vitin 2002, patologët ndërkombëtar i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Agimit dhe pas identifikimit me anë të analizës së ADN-së, Agimi u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në fshatin Grabanicë/Grabanica [Klinë/Klina].

Burimet: deklarata F.S, FDH-30785; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Selim (Osman) Aliu

(5.06.1939, shqiptar nga Pantina, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, i papunë, katër fëmijë)

Selimi kishte punuar në *Trepçë/Trepča* deri në vitin 1991, kur e pushuan nga puna. Ai jetonte në fshatin Pantinë/Pantina, me bashkëshorten Hamiden, djemtë Qamilin dhe Fadilin dhe familjen e Fadilit. Në qershor të vitit 1998, familja e braktisi fshatin, ndërsa Selimi ndenji me Fadilin, i cili ishte ushtar i UÇK-së, dhe Qamilin. Për shkak të sulmeve serbe, Selimi dhe djemtë e tij, së bashku me bashkëfshatarë, më 22.09.1998, u bashkuan me forcat e UÇK-së, të cilat ishin fshehur në pyllin e fshatit Galicë/Galica. Pas dy ditësh, më **24.09.1998**, Selimi dhe Fadili, me disa refugjatë, vendosën që të strehoheshin në Vushtrri/Vuçitrn. Ata ishin nisur më

këmbë. Në fshatin Shtitaricë/Štitarica, Selimi ishte ndarë nga Fadili dhe me një grup prej pesëmbëdhjetë njerëz, kryesisht civilë, u nisën në drejtim të fshatit **Dobërllukë/Dobra Luka**. Pas pak, Fadili kishte dëgjuar të shtënat nga drejtimi ku ishte nisur Selimi. Dy ditë më vonë, Fadili ka mësuar se Selimi kishte ndryshuar mendjen dhe ka vendosur që të shkonte në Vushtrri/Vuçitrn, te vajza Adilja. Nga motra kishte mësuar se tek ajo nuk kishte arritur. Në kërkim të babait, Fadili ishte nisur rrugës ku kishte shkuar Selimi. Atje i kishte gjetur disa nga rrobat e Selimit. Më vonë, familjarët kishin mësuar se Selimin e kishin vrarë dhe varrosur në varrezat e qytetit, në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës/Kosovska Mitrovica. Pas luftimeve më 1.11.2002, patologët e Gjykatës së Hagës i kishin zhvarrosur mbetjet mortore të Selimit dhe pas identifikimit më 20.08.2003, familjarët i rivarrosën ato në varrezat në Pantinë/Pantina.

Burimet: deklarata F.A, FDH-29583; deklarata B.B, FDH-36923; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, october-december 1998, 142, FDH-23857.

Refik (Shaban) Shabani

(17.03.1963, shqiptar nga Pantina, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, bujk, i pamartuar)

Refikiu jetonte me prindërit e vet dhe familjen e të vëllait Faikut. Për shkak të sulmeve të forcave serbe në fshat, më 20.09.1998, e gjithë familja kishte ikur në Dërvar/Drvare, ku i kishte strehuar Fehmi Imeri. Katër ditë më vonë, më **24.09.1998**, forcat serbe arritën edhe në këtë fshat. Familja ishte zhvendosur në anën tjetër të fshatit, ku ishte më sigurt, ndërsa Refiku vendosi që të shkonte në Vushtrri/Vuçitrn, te një kushëriri e tij, Eminja. Ishte përshëndetur me familjarët e vet dhe u nis më këmbë. I vëllai Faiku e kishte përcjellë me shikim deri te ura e fshatit fqinj të **Pestovës/Pestovo**, ku kishte pjesëtarë të forcave serbe. Kurrë më nuk e kishin parë të gjallë. Pas disa ditësh, kushërira Eminja ka lajmëruar se Refiku nuk kishte ardhur tek ajo. Për fatin e tij as sot nuk dihet asgjë.